



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:179560

Datë: 01.07.2021

Numri i dokumentit: 01948097

P.nr.487/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm Penal, gjyqtari i vetëm gjykues **Drilon Haraçia**, me zyrtares ligjore Arbënore Basha në çështjen penale kundër të akuzuarit K. (B.) D. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale vetëgjyqësi nga neni 410 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.nr.750/19 të datës 13.08.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor - publike, **me datë 14.06.2021**, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Kastriot Memaj, përfaqësuesit të palës së e dëmtuar av.Bardh Maksuti nga Gjakova, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av.I. Osdautaj nga Deçani, me datën 16.06.2021 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa **me datën 01.07.2021** e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

K. D., i biri i B., nënës A., e Gj.isë A., data e lindjes . . . , në fshatin . . . , Komuna e Gjakovës, ku dhe tani banon, i martuar, at i 7 fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: . . .

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 03.06.2019, rreth orës 10:00/h, në fshatin . . . , Komuna e Gjakovës, saktësisht në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarës E. M., ushtron në mënyrë arbitrare të drejtën që mendon se i takon dhe në vend që ti drejtohet organit kompetent në atë mënyrë që ditën kritike pas një mos marrëveshje pronësore i pandehuri i vendos telat rrethues në pronën e të dëmtuarës me pretendimin se është i tij, me qëllim që të ia vështirësojë punën normale, të dëmtuarës E. M., kështu që i pandehuri me veprimet e tij në mënyrë arbitrare ka ushtruar një të drejtë për të cilën ka menduar që i takon në vend që ti drejtohet organit kompetent.

- **Me këto veprime ka kryer veprën penale vetëgjyqësi nga neni 410 par.1 të KPRK-së.**

Andaj, Gjykata në kuptim të neneve **4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70** dhe nenit **410** par. 1 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej 400.00 € (katërqind) Euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë gjykata të akuzuarit ia **zëvendëson dënimin me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 20 (njëzetë) ditëve**, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burgim shumën prej 20 (njëzet) Euro.

E dëmtuara E. M., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Detyrohet i akuzuari K. D., që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumë prej 30 (tridhjetë) Euro, si dhe për programin për kompensimin e viktimave të krimit, shumën prej 30 (tridhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka paraqitur aktakuzën me numër PP.nr.750/19, të datës 13.08.2019, kundër të akuzuarit K. (B.) D. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale Vetëgjyqësi nga neni 410 par.1 të KPRK-së.

I akuzuari K. D., gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet me akuzë.

Prokurori i Shtetit Kastriot Memaj në fjalën përfundimtare ka deklaruar se Prokuroria në këtë çështje penale ka ngritur aktakuzën mbi bazën e provave materiale dhe personale nga atë cilat prova gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor me mëdyshje u vërtetua gjendja faktike e përshkruar si në dispozitivin e aktakuzës. Unë në këtë fjalë përfundimtare nuk do të jem shumë i gjatë për shkak se nga dëgjimi i dëshmitarëve në këtë çështje penale si nga dëgjimi i të dëmtuarit e cila është përfaqësuese e familjes M. - E. M., po ashtu edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve L. M., H.T., J. D. dhe I. D. të cilët u deklaruan lidhur me rastin të cilët kanë vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës. I nderuar gjyqtar në këtë çështje penale nuk është kontestues fakti se i pandehuri me datën 03.06.2019 saktësisht në fshatin . . . pra në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarve M. në parcelën 515-0 në vend që ti drejtohet organit kompetent për realizimin e të drejtës të cilën e pretendon i njëjti vendos që ti vendos telat rrethues në pronën e të dëmtuarve me pretendimin që është pronë e tij, gjë të cilën gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor nuk e kontestojë as këtu i akuzuari, pra duke u gjendur në një situatë të tillë konsiderojë se me vet deklaratën e të akuzuarit u vërtetua gjendja faktike si në dispozitivin e aktakuzës, pasi që i njëjti u vërtetua se nuk është pronarë i kësaj parcele për të cilën të dëmtuarit të drejtën e tyre e kanë të regjistruar në fletën poseduese, andaj veprimi i tij duke i mbyllur dyert në të dy anët e rrugës si dhe duke i vendosur telat me gjemba në pronën gjegjësisht në murin e të dëmtuarve nuk mund të quhet ndryshe pos vetëgjyqësi pasi që të pretendonte i akuzuari se kjo pronë është e tij, i njëjti ka qenë dashur që ti drejtohet gjykatës fillimisht për të vërtetuar pronësinë e pastaj ka mundur që të ketë të drejtë për të ndërmarrë veprime tjera, pasi që në pronën e huaj askush nuk ka të drejtë që të vendos dyer e as tela me gjemba, pasi që e drejta e pronësisë është një e drejtë e mbrojturi si me ligje vendore ashtu edhe me Konventa Ndërkombëtare, dhe se pronari ka të drejtë që të disponojë lirshëm me pronën, andaj i propozojmë gjykatës që pas analizimit të deklaratave të dëshmitarëve të cilët njëzëri konfirmuan faktin se këtu i akuzuari i ka vendosur telat me

gjemba në pronën e të dëmtuarve, gjë të cilën as ai vet nuk e ka kontestuar, dhe pas vlerësimit të këtyre deklaratave të marr aktgjykim me të cilin të akuzuarin do t shpallë fajtor, ta dënojë sipas ligjit dhe ta obligojë në pagesën e shpenzime të p procedurës penale.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar avokati Bardh Maksuti, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështesim në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit duke shtuar se kërkojmë kompensimin e dëmit.

Mbrojtësi i të akuzuarit K. D. Av. Isa Osdautaj në fjalën përfundimtare ka deklaruar se konsiderojë se aktakuza e PTHGJ nuk ka mbështetje ligjore në aspektin faktik dhe juridik, për faktin se nuk ka prova që e vërtetojnë gjendjen faktike, se me datën 03.06.2019, në oborrin e të dëmtuarës E. M. i pandehuri ka vendosur tela me gjemba. Nga provat formale si dëgjimi i dëshmitarëve edhe i palës së akuzuar fillimisht duhet të cekë se historia e rrugës për të cilën ka filluar kontesti, kjo rrugë është ndarë apo është krijuar nga ngastra 513 pronar i së cilës janë palët paditëse gjegjësisht i akuzuari me vëllezër, kjo është vërtetuar me rastin e daljes në terren, ku në shkresat e lëndës penale është ekspertiza e përpiluar nga eksperti gjeodet. Por në asnjë moment i akuzuari nuk i ka kontestuar pronësinë e 1/2 se tani janë bashkëpronar me familjen M. pasi që e kanë blerë paluajtshmërinë nga H.T.. Sot edhe më herët i pandehuri nuk e konteston se janë të vendosura dyert e oborrit, çka shihen edhe sot të cilat dyer nuk i ka vendosur që të mos i lejoj familjen M., por të njëjtat i ka vendosur për faktin se tërë sipërfaqja e ngastrës 513 ku e ka të ndërtuar shtëpinë familjare të banimit e ka të rrethuar me mur, sikurse t' ia kishte kontestuar një rrugë kalim nuk do të kishte lënë dyert të oborrit siç janë edhe sot. Është fakt se me rastin e daljes në terren është fakt se i ka vendosur telat gjembor, jo në mesin e oborrit siç pretendon prokuroria por i ka vendosur jashtë murit, të rrënuar nga vet pala e dëmtuar, dhe atë vetëm e vetëm mos me e dëmtuar pronën e familjes M. me bagëti, me shpezë apo me qenë, i ka vendosur si masë mbrojtëse, për këtë qëllim e jo siç pretendon e dëmtuara se ja ka uzurpuar pronën. Po në këtë gjykatë është vërtetuar e drejta e Servitutit të përhershëm të palës tani të pandehurit ku i pranohet e drejta e përhershme e kalimit të lirë të papenguar nga askush andaj edhe nuk ka bazë ligjore që i njëjti të ndiqet mbi këtë bazë siç përshkruhet në aktakuzë. Nga këto që u cekën me asnjë element të vetëm nuk është vërtetuar elementi i veprës penale të vetëgjyqësisë nga neni 410 par.1 të KPRK-së, andaj nga këto që u cekën më lartë, Gjykatës i propozojë që ndaj të pandehuri të marr aktgjykim lirues dhe të njëjtin ta lirojë nga akuza.

I akuzuar K. D. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështesë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësi tim.

2. Provat e administruara gjatë seancës të shqyrtimit gjyqësor

Meqenëse i akuzuari K. D. nuk e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka administruar këto prova: ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve të dëmtuarën E. M., L. M., H.T., I. D. dhe J. D. dhe ka administruar provat materiale që janë propozuar nga palët dhe atë: raportin fillestar nr. rastit 2019-EA-490 i datës 03.06.2019; raportin e oficer Y. B. 2017-EA-490 i datës 03.06.2019; Historianin e lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë nr.952-06/19 i datës 03.05.2019; Certifikatën mbi të Drejtat Pronësore të lëshuar nga DGJK numër P-70705071-00515-0 datës 18.04.2019; Ekspertizën e ëpiluar nga eksperti i gjeodezisë Xh. T. datë 03.11.2020 (C.nr.412/19); Aktgjykimin e GJTHGJ numër C.nr.412/19 i datës 14.05.2021; - Shikimi i 3 fotove me ngjyra në formatin A4 ku shihet shtëpia e të akuzuarit dy dyert para dhe prapa të hekurta si dhe muri i rrënuar i palës së dëmtuar; - Certifikata mbi të Drejtat Pronësore e

lëshuar nga DGJK numër P-1056-21 e datës 10.03.2021 në emër të B. D. së bashku me Orto Foto si dhe ka procedimin e të akuzuarit K. D. i cili është ka parashtruar mbrojtjen e tij.

2.1. Deklaratat e dëshmitarëve

2.1.1 Dëshmitarja **E. M.** gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në posedim të kësaj prone janë tre pronar Gj. M., $\frac{1}{4}$, A.M. $\frac{1}{4}$ dhe M.S.-M. $\frac{2}{4}$, ka shtruar se ne e kemi blerë një tokë rrugë së bashku me bashkëpronarët, këtë e kemi blerë prej H.dhe S.(mbiemri nuk i kujtohet) e blerë pas luftës, pra e kemi blerë tokën së bashku me rrugë dhe e kanë bartur pronësinë në emër të lartcekurve. Me datën 03.06.2019 kur kam ardhur në mëngjes në fshatin . . . , kam parë se i akuzuari në murin ku e kishim rrëzuar ne për ti vendosur rregullimin kishte vendosur telat mbi gurë pasi që i njëjti e kishte uzurpuar tërë rrugën. Telat janë të vendosur në parcelën 515 në mes të rrugës dhe oborrit, pra e ndan rrugën dhe oborrit, të drejtën për kalim e kanë vetëm pronarët legjitim, si vjehrra ime e cila gjendet në Zvicër dhe bashkëpronarët tjerë të cilët janë djemtë e axhës së burrit tim. Ka shtuar se nuk ka qenë prezentë kur është bërë shitblerja por sipas vjehrrës së saj kur është bërë shitja e kësaj parcele pronari ka thënë se mund ta rrethoni edhe rrugën së bashku me oborr nëse merreni vet me bashkëpronarët. Shton se lidhur me këtë parcelë është duke u zhvilluar një procedurë civile pranë kësaj gjykate.

2.1.2: Dëshmitari **L. M.**, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se pronarë të parcelës numër 515 janë nëna ime M.dhe djemtë e mixhës A. dhe Gj.i, ka shtuar se këtë pronë-oborritin së bashku me rrugën e kemi blerë menjëherë pas luftës dhe para se me e blerë e kemi pyetur K.in mirëpo i njëjti ka thënë se nuk ka mundësi e pastaj ne e kemi blerë nga S.A. dhe H., çmimi për 1 ari ka qenë 3.500,00 €. Për blerjen e tokës kemi kontratën e vërtetuar në gjykatë, ku prezentë ka qenë i akuzuari K. D. kur është dorëzuar prona nga shitësi, por i akuzuari pasi e kemi blerë tokën e ka uzurpuar dhe e ka mbyllur pjesën hyrëse dhe fundin me dyer, duke shtuar se nuk e di se çka ka ky me mixhallarët e vet, telat i ka vendosur tek muri i cili ka qenë i ndërtuar që 38 vite. Shton se e ka njoftuar bashkëshortja për vendosjen e telave e që ai mendon se janë vendosur natën, pasi që ai vet është nisur për Zvicër në mëngjes e nuk ka mund ti shoh vet telat e vendosur. Ka shtuar dyert kanë qenë të mbyllura dhe se i akuzuari i i ka thënë se nëse dëshiron me hy ndokush unë ju hapi dyert. Në pyetjen e të akuzuari Se a të kujtohet se kur kanë qenë të vendosura dyert e drurit më herët, është përgjigjur se më kujtohen se janë heq dhe janë vendosur tjera, më kujtohet se parcela e të akuzuarit ka qenë me gardh e ndarë nga rruga deri në daljen tjerë, ndërsa tani nuk është e rrethuar duke shtuar se prej se janë vendosur dyert e hekurit është hequr gardhi. Gjykata ka pyet dëshmitarin se a ka vend tjetër për të shfrytëzuar pronën e tij, dëshmitari ka deklaruar se po e ka nga rruga kryesore hyrjen, është pyetur se kur e kemi blerë rrugën nga blerësit a ju kanë treguar se në këtë rrugë ka të drejtë edhe K.i apo dikush tjetër ta shfrytëzoj, është përgjigjur jo përveç vëllezërve të blerësve, ka shtuar se ne kemi hyrje tjetër nga vëllai dhe djemtë e mixhës ndërsa për të shkuar në parcelën tjetër nuk kemi kah të shkojmë vetëm rrugës kontestuese, kemi kundërshtuar vendosjen e dyerve, por i akuzuari na ka thënë se kur doni të kaloni unë ju hapi dyert.

2.1.3: Dëshmitari **H.T.**, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se jam në dijeni, në vitin 1979 axha A. T. dhe unë në vitin 1980 ia kemi shitur një pronë B. K. D. në sipërfaqe prej 19 ari dhe 15 metra katror, kjo ka qenë sipas listës poseduese, ndërsa 2 ari e 29 metra katror e kemi lënë si rrugë private për me shku na në një pronë tjetër nja 300-400 metra largësi, dhe për këtë që deklarojë ekzistojnë edhe fletë posedimi. Shton se këtë rrugë e kemi lënë për ne dhe për axhën për nevojat tona e cila është e regjistruar si rrugë private. Shton se në vitin 2005 ia kemi shitur familjes M. parcelën dhe rrugën dhe ia kemi bartur të gjitha të drejtat pronësoro juridike bile bile edhe servitutit sendor. Rrugën për shfrytëzim ky e ka pasur në rrugën kryesore, e ka shtëpinë

derën e oborrit, e nuk ka nevojë me e shfrytëzuar këtë servitut dhe asnjëherë nuk ka ra në te. Në pyetjen e prokurorit se në cilin vit ia keni shitur parcelën nr.515 familjes M., dëshmitari ka deklaruar se në vitin 2005, pastaj neve ia kemi bartur të drejtat juridike shit blerësve sipas kontratës së legalizuar ka pasur, shton se nga familja M. jemi njoftuar në vitin 2006 se është duke e penguar ndërsa në vitin 2009 janë vendosur portat e metalit në të dy anët veriore dhe lindore, kemi shkuar me biseduar dhe nuk jemi marrë vesh, kemi pasur diskutim me të akuzuarin K., pasi që njëherë kanë qenë jo serioz, kanë thënë se nuk ia kemi paguar 1,50 metra dhe kanë thënë se jemi në gjendje me ja paguar shumën prej 5.000,00 € dhe kemi kundërshtuar dhe i njëjti ka cekur se është e imja. Unë nuk jam marr me atë parcelë. Në pyetjen e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar avokati Bardh Maksuti se ju a keni qenë në vendin e ngjarjes në procedurën civile kur gjykata ka dal me ekspertët, e atëherë keni vërejtur se dyert janë vendosur në hyrje dhe në dalje, dëshmitari është përgjigjur po dhe kam vërejtur murin e rrënuar po ashtu edhe telat e vendosur në muri, gurët e murit kanë qenë në oborrin e familjes M., rruga për të cilën bëhet fjalë është e familjes M., Gj. M., A.M. dhe M.M.. Në pyetjen e Gjykatës se rruga e cila ka qenë në mes të familjes M. dhe D. a ka pasur rrethim nga ana e familjes D., dëshmitari është përgjigjur po ka pasur rrethim me tela me xhemba të cilat i ka vënë familja D., rrugën private e kemi shfrytëzuar unë dhe axha.

2.1.4: Dëshmitari **I.D.**, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se jam në dijeni ku L. M. e ka rrënuar murin e shtëpisë së vjetër ku ai mur është mbi 100 vite dhe ka dashtë me dal 2-3 metra përtej murit në oborr të K. D. dhe K.i i ka thënë se nuk të lë me bo mur këtu, L.i i ka thënë se unë e kam blerë këtë pjesë prej H.T., K.i i ka thënë se 1,50 metër rrugë është e imja dhe 1.50 metra e H.t dhe nuk mund ta shet rrugën teme ty. L.i e ka paraqitur rastin se K.i nuk po më lenë me punuar. Jo, nuk kam par tela gjembor të vendosur në oborrin e familjes M. duke shtuar se nuk ka as sot. Në pyetjen e parashtruar nga prokurori në pyetjen e mbrojtësit të të akuzuarit ju thatë se K.i i ka thënë se nuk të lë me e qit zidin këtu. A është e vërtetë që K.i i ka thënë se nuk të lë me e qit murin këtu, dëshmitari është përgjigjur se në rrugën e vet po. K.i kufizim me këtë rrugë nuk ka pasur pasi që rruga është në parcelë të K.it ndërsa muri kufizues ka qenë ai të cilin e kanë rrëzuar. K.i e ka shfrytëzuar rrugën, ndërsa familja M. e nuk e ka shfrytëzuar. Po atë rrugë e ka shfrytëzuar edhe H.T. si rrugë sezonale, duke i thënë K.it se a po mi hap dyert për me e shfrytëzua parcelën-arën e vet. E di që parcela e H. që është më lart se rruga i është shitur familjes M., Ka shtuar se pas rrënimit të murit kur K.i i ka thënë se nuk të lë me e zapu rrugën, K.i i ka vendosur telat me xhemba afër murit në mexhen e vjetër. Në pyetjen e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar avokati Bardh Maksuti a është e vërtetë se ju keni qenë dëshmitar edhe në procedurën civile, dëshmitari është përgjigjur po, sot e kam kuptuar se e ka blerë atë tokë, ndërsa në atë kohë nuk e kam ditur se e ka blerë. Po kam vërejte se përtej mexhes janë telat e vendosur nën murin e M.

2.1.5: Dëshmitari **J.D.**, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se po kam njohuri, se familjet M. dhe D. kanë konflikt lidhur me një rrugë të cilën dëshmitari H.ia ka shitur familjes M. një pjesë të rrugës së K.it, shton se familja M. ka dal me e nxon atë rrugë me arsyetimin se e ka blerë, ndërsa K.i nuk e ka lejuar. Nuk ka parë tela xhembor në oborrin e familjes M. kurrë. Po mur ka qenë në mes të familjes M. dhe D., ka qenë i familjes M. që e ka rrënuar emri nuk më kujtohet, pasi që jetojnë në botën e jashtme dhe e ka rrënuar me qëllim me e nxon rrugën. Nëpër atë rrugë kalojnë vetëm familja K.i dhe familja D., kjo rrugë të dërgon nën edhe në pjesën e H.t të cilën ia ka shitur familjes M.. Nuk e di se çfarë fjalë kanë ndërruar, por e di që K.i nuk e ka lejuar familjen M. me dal tutje. Shtëpinë e kam në afërsi prej 70 metra pranë familjes M.. Ku ka kufizim xhembor nga parcela e të akuzuarit, në mënyrë që mos të dalin kafshët, oborri i shtëpisë së të akuzuarit është i rrethuar-kufizuar me tela me xhemba me rrugën. Kam dëgjuar se rruga iu është shitur familjes M. ndërsa shton se familja M. nuk ka kaluar në atë rrugë për të shkuar tek

parcela pasi që e ka bashkuar parcelën me pronën e vet dhe nuk ka pasur nevojë për te. Prokurori ka pyet se a mundesh me na tregu se muri i familjes M. a ka aktualisht tela për rreth? Dëshmitari ka deklaruar se po ka të cilat i ka vendosur K.i. Deri sa kam ardhur në gjykatë nuk e kam ditur që kjo rrugë është e regjistruar në emër të familjes M.? Dyert në hyrje dhe dalje, K.i i ka vendosur, rreth 35 vite dhe këtë rrugë e ka shfrytëzuar edhe H..

2.2 Provat materiale

2.2.1 Nga raporti fillestar i incidentit me nr. rastit 2019-EA-490 të datës 03.06.2019 janë përshkruar veprimet hetimore të ndërmarra nga Policia e Kosovës lidhur me rastin i cili ka ndodhur me dt.03.06.2019 në fsh.. . . , Komuna e Gjakovës, ku është paraqitur si e dëmtuar E. M., ndërsa si i dyshuar K. D..

2.2.2 Nga Historiati i lëshuar nga Drejtoria për kadastër Gjeodezi dhe Pronë me nr.952-06/19 datës 03.05.2019 është konstatuar ndër tjerash në bazë të kontratës së shitblerjes VR.nr.2354/07 të dt.20.07.2007 parcela me numër 515 ka kaluar në posed të: ¼ Gj. M., ¼ A.M. dhe 2/4M.M., kjo gjendje e pa ndryshuar deri ne ditët e sotme.

2.2.3 Nga Certifikata mbi të Drejtat Pronësore të lëshuar nga DGJK n.P-70705071-00515-0 të datës 18.04.2019 së bashku me skicën, shihet se parcela me numër 515-0, në sipërfaqe prej 229 m² ZK . . . është në bashkë posedim të: ¼ Gj. M., ¼ A.M. dhe 2/4M.M., përshkrimi i pronës është “Rrugë private”.

2.2.4 Nga raporti i oficerit Y. B. me nr. 2017-EA-490 datës 03.06.2019, është konstatuar se me datën 03.06.2019 zyrtarët policor kanë shkuar në fshatin . . . për të verifikuar lidhur me një mosmarrëveshje pronësore ku ankuesja E. M. ka paraqitur rastin se pasi ishte duke shkuar në shtëpinë e saj në . . .ka vërejtur se fqinji i saj K. D. kishte vendosur tela rrethues në pronën e tyre respektivisht pronën me fletën poseduese me numër të parcelës P-70705071-00515-0 e cila gjendej në emër të vjehrrës së sajM.M., e që K. D. pretendonte se ajo pronë private i takon atij por që nuk posedon asnjë dokument në lidhje me atë parcelë. Në atë lokacion nga ana e zyrtarëve policor të njësisë së hetimeve është bërë edhe fotografimi i vendit të ngjarjes, janë lajmëruar inspektorët komunal, zyrtarët kanë shkuar edhe tek shtëpia e të dyshuarit K. D. por nuk e kanë gjetur aty, ku i njëjti ka pranuar se ka vendosur telin rrethues përsëri murit të rrëzuar mirëpo këtë e ka bërë për arsye mos me i shkaktuar dëme, e kurrsesi për qëllim të përvetësimit të pronës apo diçka tjetër, pasi që ka treguar se në Gjykatën Themelore në Gjakovë është hapur një kontest pronësor.

2.2.5 Nga Ekspertiza – Plotësim ekspertiza gjeodezike të përpiluar lidhur me lëndën civile numër C.nr.412/19 të përpiluar nga eksperti Xh. T. datë 03.11.2020 është konstatuar se nga ana perëndimore në grafikë e shënuar si H1 ka gjerësi prej 3,40 m, ndërsa lartësi prej 2.60m, dera nga ana lindore në grafikën e shënuar si H2 ka gjerësi prej 3,70 m, ndërsa lartësi prej 3,10m. Gjendja kadastrale e parcelën 515-0 nga vija e kuqe jugore gjer ne vijën e zezë veriore në grafikë është shënuar si b) ka sipërfaqe prej S=163 m². Gjerësia faktike e rrugës tek porta perëndimorë (H1) nga vija e kuqe në jug në vijën e zezë në veri është 2.65 m. Gjerësia faktike e rrugës tek porta lindore (H2) nga vija e kuqe në jug në vijën e zezë në veri është 2.86 m.

2.2.6 Nga Aktgjykimit të GJTHGJ me C.nr.412/19 të datës 14.05.2021 i cili aktgjykim nuk është i formës së prerë si dhe ankesa e parashtruar ndaj të njëjtit aktgjykim nga pala e dëmtuar, në këtë aktgjykim të akuzuarit iu është refuzuar e drejta e bashkë pronësisë, ndërsa iu

është njohur e drejta e përhershme e servitutit të kalimit në parcelën 515-0 e cila është objekt i kësaj çështje penale.

2.2.7 Nga shikimi i 3 fotove me ngjyra në formatin A4 ku shihet shtëpia e të akuzuarit, 2 dyert para dhe prapa të hekurta si dhe muri i rrënuar i palës së dëmtuar, nga foto nr.1 shihet shtëpia e të akuzuarit dhe porta – dera e hekurit e vendosur ngjitur me shtëpinë e tij dhe muri i të dëmtuarit i cili shihet i rrënuar. Nga foto numër dy shihet porta e hekurit në anën tjetër të parcelës, po ashtu në foton nr.3 shihet dera e hekurit përball dhe krahas anës së djathtë muri i rrënuar i familjes M..

2.2.8 Nga Certifikata mbi të Drejtat Pronësore të lëshuar nga DGJK n.P-1056-21 të datës 10.03.2021 në emër të B. D. së bashku me OrtoFoto, ku janë konstatuar rrugët rreth parcela si dhe rruga për të cilën bëhet fjalë në këtë procedurë.

2.3 Mbrojtja e të akuzuarit

2.3.1 I akuzuari K. D. gjatë shqyrtimit kryesor nuk e ka pranuar fajësinë ndërsa në mbrojtjen e tij ka deklaruar se unë tokën ku është shtëpia e kam blerë në vitin 1979 prej A.T.t, pjesën tjetër e kam blerë prej H.T.t në vitin 1980, kur e kam blerë prej H.t e kam blerë me gjithë 1.50 metër si rrugë të përbashkët për ne dhe për H.n në tërësi 3 metra rrugë. Prej vitit 1980 unë i kam vendosur dyert në të dy anët pasi që nuk ka pasur hyrje dalje përveç nesh dhe A.t dhe pjesëtarët e tij të familjes, dhe prej atij viti kanë qenë herë me dërrasa herë me thupra, ndërsa pas luftës i kemi vënë të hekurit, shton se në vitin 2005 e kam kuptuar se ia kanë shitur parcelën familjes M. ndërsa për rrugë nuk më ka pyetur kush. Ndërsa për rrugë e kam kuptuar që e ka shitu kur ma ka dërguar policinë pasi që e kishte prishur zidin dhe më ka lajmëruar se jom ka e pengojë. Unë i kam thënë : Se zidi është i ti nuk muj me ta ndalu dhe i njëjti më ka thënë : Se jam duke e prishur se du mi shti në oborr edhe rrugën pasi që është e imja, ku unë i thashë : Se nuk lejoj, pasi që është rrugë e përbashkët ku është edhe Gj.i e A., as tash nuk e pengojë me kalu pasi që rruga është e përbashkët. Prej vitit 1980 kur e kam blerë parcelën. Unë i kam vënë telat në pjesën time ku e ka prishur zidin në mënyrë që të mos kalojnë bagëtitë për mos me i bërë dëme. Prokurori ka pyetur se ju thatë që në vitin 2005 H. ia ka shitur parcelën familjes M., a kanë ndonjë rrugë tjetër përpos kësaj rruge? I akuzuari ka deklaruar se po, kanë pasi që parcela është e ngjitur për shtëpinë, por shtojë se edhe kjo rrugë të dërgon tek ajo parcelë. Po, lejohet ta shfrytëzojë edhe familja M., mirëpo nuk ma kanë kërkuar dhe shtojë se unë gjithmonë do ti lejoj që të kalojnë, dyert e hekurta janë të mbyllura me shul prej anës së brendshme dhe jo me qelës. Prokurori ka pyet se ju thatë që pasi është rrënuar muri ju i keni thënë familjes M. se nuk do ti lejoni që të zgjerohet oborri në drejtim të rrugës. A është e vërtetë ? I akuzuari ka deklaruar se po është e vërtetë pasi është rrugë e përbashkët. Prokurori ka pyet se ju deklaruat se i keni vendosur telat me gjemba? I akuzuari ka deklaruar se po është e vërtetë i kam vendosur nga muri të cilin e ka rrënuar familja M.. Prokurori a keni qenë në dijeni se kjo rrugë evidentohet në emër të familjes M.? I akuzuari ka deklaruar se e kam kuptuar kur është hapur rasti në polici. Av.Bardh Maksuti ka pyetur se a mendon që ke të drejtë të mbash dyert e mbyllura në pronën e huaj? I akuzuari ka deklaruar se nuk është krejt e huaja, por e kemi të përbashkët edhe asnjëherë nuk më kanë kërkuar me e shfrytëzuar. Gjykata ka pyet se a ta ka ofruar H. ndonjëherë këtë rrugë për ta shitur? I akuzuari ka deklaruar se jo se po të ma ofronte e kisha blerë.

3. Elementet e veprës penale

Në nenin 410 parag.1 të KPRK, është parashikuar se veprën penale vetëgjyqësi e kryen: “Kushëdo që ushtron në mënyrë arbitrare të drejtën që mendon se i takon në vend se t’i drejtohet organit kompetent, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj”.

4. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Gjyqtari i vetëm gjykues, ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se nuk duhet t’i falet besimi mbrojtjes së të akuzuarit K. D. të dhënë gjatë seancave të shqyrtimeve gjyqësore me të cilin e mohon kryerjen e veprës penale ngase kjo sipas vlerësimit të gjykatës është bërë thjeshtë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale. Gjykata nuk ja fali besimin mbrojtjes së të akuzuarit për shkak se është në kundërshtim me provat të cilave gjykata ja ka falur besimin, siç janë deklaratat e të dëmtuarës – dëshmitares E. M. të dëshmitarëve L. M., H.T., I. D. dhe J.D., po ashtu nga prova materiale si Historiati i lëshuar nga Drejtoria për kadastër Gjeodezi dhe Pronë me nr.952-06/19 datës 03.05.2019, Certifikata mbi të Drejtat Pronësore të lëshuar nga DGJK n.P-70705071-00515-0 të datës 18.04.2019 së bashku me skicën, Raporti i oficerit Y. B. me nr. 2017-EA-490 datës 03.06.2019, Ekspertiza – Plotësim ekspertiza gjeodezike të përpiluar lidhur me lëndën civile numër C.nr.412/19 të përpiluar nga eksperti Xh. T. datë 03.11.2020, ku Gjykata nga dëshmitarët E. M., L. M., J.D. dhe I. D., ka vërtetuar se i akuzuari me dt.03.06.2019 (si në aktakuzë) pasi që familja M. kishte rrënuar murin e vjetër në parcelën e tyre i akuzuari K. D. kishte vendosur telat rrethues rreth murit të rrënuar duke i thënë familjes M. se nuk bënë ta zgjeroni murin kufizues pasi që është rrugë edhe pse i akuzuari fillimisht ka deklaruar se nuk e ka ditur se është rruga në emër të familjes M. (shitja e rrugës nga H.T.), pastaj ka deklarua se e kam pasur të drejtën që të kalon nëpër këtë rrugë ku e kanë shfrytëzuar familja T., pastaj ka deklaruar se me familjen T. para shumë vitesh kemi lënë që të dy familjet nga 1.50 metra që të shërbej si rrugë, si dhe është thirrur se janë të vendosura dyert e hekurta në pjesën hyrëse dhe dalëse të parcelën nga vet i akuzuari duke pretenduar se është pronar (mos lejimi i shfrytëzimit të rrugës familjes M.), pra i akuzuari nuk e ka kontestuar asnjëherë që i ka vendosur telat rrethues rreth murit të rrënuar tek familja M. (kjo është vërtetuar edhe nga dëshmitarët), andaj kjo Gjykatë konsideron se me rastin e vendosjes së telave rrethues rreth murit të rrënuar nga familja M. është konsumuar vepra penale e vetëgjyqësisë pasi që i akuzuari nuk iu është drejtuar organit kompetentë shtetëror për këtë çështje por ka vendosur që vet të bëjë drejtësinë por me të parë situatën më vonë iu është drejtuar gjykatës në procedurë kontestimore siç vërtetohet edhe nga Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë me numër C.nr.412/19 të datës 14.05.2021 i cili aktgjykim nuk është i formës së prerë, ku të akuzuarit iu është refuzuar e drejta e bashkë pronësisë, ndërsa iu është njohur e drejta e përhershme e servitutit të kalimit në parcelën 515-0 e cila është objekt i kësaj çështje penale, por kjo nuk do të thotë se pala e dëmtuar nuk ka të drejtë ta shfrytëzoj (pasi që i akuzuari ka deklaruar se asnjëherë nuk më kanë kërkuar që ti lejoj ta shfrytëzojnë), pasi që nga Certifikata mbi të Drejtat Pronësore të lëshuar nga DGJK n.P-70705071-00515-0 të datës 18.04.2019 konstatohet se parcela me numër 515-0, në sipërfaqe prej 229 m² ZK . . . është në bashkë posedim të: ¼ Gj. M., ¼ A.M. dhe 2/4M.M., përkrahimi i pronës është “Rrugë private”. Këtë të drejtë familja M. e ka fituar në bazë të kontratës së shitblerjes VR.nr.2354/07 të dt.20.07.2007 parcela me numër 515 ka kaluar në posed të: ¼ Gj. M., ¼ A.M. dhe 2/4M.M., kjo gjendje e pa ndryshuar deri ne ditët e sotme, çka do të thotë se i akuzuari nuk ka ndonjë dokument valid mbi të drejtat pronësore. Andaj kjo Gjykatë duke pasur parasysh faktin se e dëmtuara-dëshmitarja E. M., L. M. J.D. dhe I. D. si dhe vet i akuzuari kanë dëshmuar ku edhe vet i akuzuari nuk e ka kontestuar se i ka vendosur telat rrethues (me arsyetimin se mos të dalin bagëtitë), Gjykata nuk ia fali besimin mbrojtjes së të akuzuarit pasi që e njëjta është në kundërshtim deklaramet e dëshmitarëve dhe me provat materiale të cilat kanë ndikuar që të akuzuarin ta shpall fajtor, andaj Gjykata ka vërtetuar se me veprimet e të akuzuarit K. D. është

vërtetur dhe janë formuar elemente e veprës penale vetëgjyqësisë nga neni 410 paragrafi 1 andaj duke u bazuar në të lartcekur Gjykatën të akuzuarin e ka shpallur fajtor.

Lidhur me pretendimet e mbrojtjes se i akuzuari nuk ka kryer veprën penale pasi që kemi të bëjmë me bashkëpronësi – procedurë kontestimore dhe sipas aktgjykimit të kësaj Gjykate ku iu është njohur e drejta e shfrytëzimit të përhershëm si dhe vendosja e telave xhëmbor ka ardhur si rezultat i ruajtjes mos me e dëmtuar pronën e familjes M. me bagëti, me shpezë apo me qenë, i ka vendosur si masë mbrojtëse, për këtë qëllim e jo siç pretendon e dëmtuara se ja ka uzurpuar pronën, kjo Gjykatë nuk ia fali besimin pasi që i akuzuari me veprimet e tij ka konsumuar veprën penale të vetëgjyqësisë pasi që sipas deklaratimit të tij dhe të dëshmitarëve qëllimi i tij ka qenë të vendos telat rrethuese për të mos lejuar familjen M. të bëjë zgjerimin e murit rrethues e jo siç pretendon të mbrojë pronën për shkak të bagëtive, pra i njëjti është dashur të drejtohet organeve kompetente për të vendosur lidhur me këtë të drejtë të pretenduar, e jo ta marr drejtësinë në dorë, andaj sipas Gjykatës pretendimet e mbrojtjes janë të pa bazuara.

5. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, pas administrimit të gjitha provave gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se i akuzuari K. D., me dashje e ka kryer veprën penale vetëgjyqësi nga neni 410 paragrafi 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përhshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

6. Vendimi për shpalljen fajtor të akuzuarit

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e shpalli fajtor të akuzuarin K. D. për shkak të veprës penale vetëgjyqësi nga neni 410 paragrafi 1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

7. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: se jeton vet i treti në familje, është mbajtës i vetëm i familjes, bujk, qëndrimi i tij korrekt gjatë seancave, po ashtu se nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë veprën penale. Ndërsa duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së dhe se ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko – civil, është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.2 lidhur me par.1 të KPP-së.

9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm Penal-
P.nr.487/19, me datë 01.07.2021

Zyrtarja ligjore,
Arbënore Basha

Gjyqtari i vetëm gjyqës,
Drilon Haraçia

KËSHILLA JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.